

Garantimi i Cilësisë

INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin ” PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.9180, datë 05.02.2004”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të saj ajo ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice).

INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi ndaj përdoruesit, orientimi ndaj punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Këto parime përshkruhen në mënyrë të detajuar në materialin Deklarata e Cilësisë e INSTAT.

- **Paanshmëria** - që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit.
- **Cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore** - INSTAT kujdeset për cilësinë e proceseve dhe produkteve statistikore dhe kështu udhëhiqet nga parimet si: rëndësia, saktësia, koha, përpikëria, e drejta e hyrjes, qartësia, krahasueshmëria dhe koherenca.
- **Orientimi ndaj përdoruesit** - INSTAT përpiqet që të prodhojë statistika sa më afër nevojave të përdoruesve, përpiqet të njohë dhe të përmbush pritshmëritë e tyre dhe në këtë mënyrë të sigurojë përmbushjen e plotë të nevojave për të dhëna statistikore zyrtare.
- **Orientimi ndaj punonjësit** - INSTAT kujdeset për kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe kompetencave të tyre, duke ndikuar kështu në rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së punonjësve të cilët kontribuojnë efektivisht në proceset e punës.

- **Efektiviteti i proceseve statistikore** - është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i ngarkesës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar.
- **Reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve (response burden)** - INSTAT përpiqet që të dhënat statistikore zyrtare të jenë të kuptueshme për të intervistuarit, në mënyrë të tillë që të reduktojë ngarkesën e raportimit, duke përdorur metoda moderne të mbledhjes së të dhënave si dhe duke përdorur burimet administrative, kur lind nevoja.